

QKB

**AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Arakopi” Sh.p.k.**

Sot me date 15.01.2018 kerkohet themelimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar “Arakopi” Sh.p.k. duke formuluar statutin e saj si me poshte vijon ne perputhje me ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ortaku i Shoqërisë “Arakopi” Sh.p.k., miraton Statutin e shoqerise si më poshtë:

**KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA**

**Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1.1 Themeluesi i shoqerise është:

-Z. Altin Hyseni Mukaj, i biri i Beqarit dhe Dritës, i datlindjes 21.06.1977, shtetesi spanjolle, lindur ne Levan Tepelene dhe banues ne Madrit, Spanje, identifikuar nepermjet Pasaportes (Pasaport Espana) Nr. PAA357758 dhe Kartes se Identitetit (Documento Nacional de Identidad) DNI NUM. 50490024X madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar;

1.2 Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte **“Arakopi” Sh.p.k**

1.3 Shoqeria **“Arakopi” Sh.p.k.** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar (me pas refeuar si **“Ligji Tregtar”**) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).

1.4 Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne registrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit (me pas refeuar si **“QKB”**) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji. Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet perjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

1.5 Ortaku i Shoqerise do te jene perjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoq



Neni 2
Selia

2.1 Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: *Rruja "Don Bosco", Perballe "Vizioni Plus", Kulla 5, Kati 5, Tiranë, Shqipëri.*

2.2 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Objekti

3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë: "*Tregetimi me shumice e pakice, Sherbim spacioni brenda dhe jashtë vendit, Tregtim artikujsh te ndryshem, Sherbime transporti brenda dhe jashtë vendit, per llogari te vete dhe per te trete. Sherbime ne ndertim etj, punime ne fushen e ndertimit ne zerat, germime dheu ne punimet eventuale, murature e beton arme-prishje dhe punime ne toke te germuar. Prodhim materiale inerte - gure. Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme-paranderur gure dekorative. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, deri ne 5 kate. Rikonstruksione. Ndertime banesa me skelet mbi 8 kate, Ndertim rruge kat. IV dhe V. Ndertim rruge kat.III dhe II-I. Punime te mirembajtjes, dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore. Ndertim ujesjellesa - kanalizime - kanale e impiante vaditeze. Punime mbrojtese te sistemit hidraulik-cimentime etj. Punime karpenterie druri etj. Prodhim dhe tregetim tekstilesh dhe aksesoresh te ndryshem etj., Import -Export me shumice dhe pakice te çdo lloj malli te parashikuar ne tabelat doganore te Republikës se Shqiperise. Import-eksport te makinave dhe makinerive te renda, autoveturave te te gjitha llojeve dhe tregimin e pjeseve te nderrimit, dhenien me qera te tyre etj. Agjensi transporti, publicitet, reklama dhe propaganda.*".

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjeter të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.


3.2 Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

Neni 4
Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar.

4.2 Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI II
KAPITALI – KUOTAT



Neni 5 **Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,00 (njeqind Leke). Kapitali themeltar perbehet nga 1 (një) kuote me vlerë nominale 100 ALL (njeqind Leke), dhe eshte paguar e zoterohet teresisht nga ortaku themelues z. Altin Hyseni Mukaj.
- 5.2 Ortaku është perjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- 5.3 Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.
- 5.4 Kontributi i ortakut mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri e luajtshme/e paluajtshme apo të drejta)

Neni 6 **Kuotat** **Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**

- 6.1 Çdo ortak ka te drejte vote ne perpjestim me vleren nominale te kuotes se tij.
- 6.3 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen perjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").
- 6.2 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e me poshtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

Neni 7 **Transferimi i Kuotave**

- 7.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme nepermjet trashegimise, shitblerje, dhurim ndermjet Ortakeve ekzistues ose personash te trete pasi ti jete ofruar me pare ortakut ekzistues.
- 7.2 Kalimi i te drejtave te pronesise, venia peng, barre apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat do te kerkoje, ne menyre qe te prodroje efekt, miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila vendos me shumice te thjeshte.
- 7.3 Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi nje numer kuotash ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.
- 7.4 Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij, ai, perpara se te nenshkruejte marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftojte me shkrim

Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale te transferimit.

- 7.5 Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar - do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.6 Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftojne me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- 7.7 Administratoret brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.8 Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes, ata do te blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.9 Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak sipas nenit 7.6 me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'ia transferoje keto kuota personit/ave te percaktuar.
- 7.10 Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuotat objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit te percaktuar nga neni 7.6 me siper.
- 7.11 Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

Neni 8 **Zmadhimi i Kapitalit**

- 8.1 Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji.
- 8.2 Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrinin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njezet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.
- 8.3 Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.
- 8.4 Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar mund te zmadhoje kapitalin themeltare te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzities ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates.
- 8.5 Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te ri ne shoqeri pranohet vetem kur Asambleja e Pergjithshme voton me shumice te kualifikuar te votave te ortakeve.

Neni 9 **Zvogelimi i Kapitalit**

- 9.1 Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

- 9.2 Zvogelimi i kapitalit te shoqeri pranohet vetem kur Asambleja e Pergjithshme voton me shumice te kualifikuar te votave te ortakeve.

KAPITULLI III **ORGANET E SHOQERISE**

Neni 10 **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

- 10.1 Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte vendimarrës i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- peraktimi i politikave tregtare;
 - ndryshime te Statutit;
 - emerimi dhe shkarkimi i Administratoreve;
 - emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
 - miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
 - shperndarjen e fitimeve vjetore;
 - zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
 - pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
 - perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
 - riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
 - miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
 - çeshtje te tjera sipas parashikimeve te ketij Statuti.
- 10.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.
- 10.3 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.
- Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vedin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vedin e menyren e marries se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, adresen e faqes se internetit te Shoqerise ku mund te merret informacioni, po ashtu edhe rendi i dites, dhe duhet t'u njoftohet te gjithe Ortakeve te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.
- 10.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.



- 10.5 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret dhe nga ortaku i cili zoteron te pakten 5% te kapitalit te rregjistruar ne shoqeri nepermjet ndermjetesimit te administratorit apo duke ju drejtuar drejtperdrejte shoqerise i cili kur nuk i drejtohet ndermjetesimit te administratorit drejton mbledhjen.
- 10.6 Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
- 10.7 Ne rastin e vendimeve te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar Ortaket qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar. Ne keto raste Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te marrre vendime me shumicen e votave te kapitalit pjesemarres, vec kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar dhe/ose ky Statut.
Per cesh tj, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, si ndryshimi i Statutit, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit, shperndarja e fitimit, ristrukturimi dhe prishja e Shoqerise, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar Ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te regjistruar dhe do te marrre vendime me ¼ (tre te katertat) e votave te kapitalit pjesemarres.
Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi, Asambleja mblidhet perseri brenda 30 diteve me te njejtin rend dite.
- 10.8 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njojur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.
- 10.9 Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergiegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.
- 10.10 Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe administratorin nga detyra me shumice te zakonshme me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 30% te kuotave.

Neni 11

Organi Administrues / Administratoret

- 11.1 Organi Administrues perbehet nga 1 (një) Administrator qe emerohen e shkarkohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 3 (tre) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i parë i shoqërisë me mandat 3 vjeçar:

- **Z.Olsen Kojanaj**, i biri i Omer dhe Vojsava, i datlindjes 17.06.1992, lindur ne Orikum Vlore, banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Don Bosco", Tiranë, identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. 029714418 dhe numer personal J20617065M, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar;



Administratorit perfaqeson Shoqerine me te drejta dhe kompetanca te plota sipas parashikimeve te Statutit.

11.2 Administratori do te:

- (i) administrojne veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesojne Shoqerine;
- (iii) kujdesen per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqesin Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijojne nje sistem rjoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryejne regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportojne perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryejne detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrasin mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Neni 12
Kontroll i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14
Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezevre te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezevre te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 15
Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.



KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 16
Prishja e Shoqerise

Shoqeria prishet (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimitari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsyte tjetra te parashikuara ne ligj.

Neni 17
Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 18
Dispozita Perfundimtare

- 18.1 Per te gjitha ceshjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.
- 18.2 Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrerhit gjyqesor ku Shoqeria ka seline e saj.
- 18.3 Me qellim shmangjen e cdo paqartesie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjeter nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.
- 18.4 Ky Statut nenshkruehet rregullisht ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I SHOQERISE
" Arakopi " sh.p.k
Altin Hyseni Mukaj

ACTIV HYSENI MUKAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE ERMIRA B. KAPLLANI

ADRESA: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla II, Kati I

Mob. 067 25 77 372;

e-mail: ermira.kapllani@hotmail.com

Nr. 116 Rep



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me date 15/01/2018 (dymije e tetembedhjete), ne Tirane, perpara meje Noteres Ermira B. KAPLLANI, anetare e Dhomës se Noterise Tirane, u paraqit personalisht shtetasit:

Z. **Altin HYSENI MUKAJ**, i biri i Begarit, lindur me 21.06.1977 ne Levan, Tepelene, banues ne Spanje, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar me dokumentin Pasaporte Spanjolle nr.PAA357758, date leshimi 06.03.2015 me date skadence 29.05.2024, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise ne procedura regjistrimi si person juridik "Limah" sh.p.k., i cili me vullnet te lire e te plete dhe nen per gjegjesine e tij ligjore deklaroit se ka hartuar dokumentin: "Akt themelimi dhe statut i shoqerise "Limah" sh.p.k." bashkelidhur ketij akti, te cilin e nenshkroi rregullisht para meje Noteres.

Unë Noterja, pasi bëra verifikimin e shtetasit te lartecituar, nepermjet dokumentit te identifikimit dhe mbeshtetur ne Ligjin nr.7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar, vërtetoj nenshkrimin e tij.

NOTERE
ERMIRA B. KAPLLANI

